



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E APELIT VLORË

Nr.2185 i Regj.Them.  
Datë 18.05.2018

Nr.850 i Vendimit  
Datë 18.10.2018

VENDIM  
"NE EMËR TE REPUBLIKES"

Gjykata e Apelit Vlorë e përbërë prej:

KRYESUES: Hysen SALIKO  
ANËTAR: Klodiana GJYZARI  
ANËTAR: Nazmi TROKA

Asistuar prej sekretares [REDACTED], në Vlorë sot më datë 18.10.2018, mori në shqyrtim në séancë gjyqësore në shkallë të dytë çështjen civile me Nr.2185, Akti që u përket:

**PADITËS:**

[REDACTED] e bija e [REDACTED] dhe e [REDACTED] e datëlindjes [REDACTED], lindur në [REDACTED] dhe banuese në [REDACTED] në mungesë.

**I PADITUR:**

Shoqëria "Albpetrol" sh.a, me seli në Tiranë, përfaqësuar nga juristi [REDACTED]

**Person i Tretë:**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në mungesë.

**Me Pjesëmarrjen:**

E Avokaturës së Shtetit, Zyra Vendore Vlorë, në mungesë.

**OBJEKTI:**

1. Konstatimin e faktit të diskriminimit të drejtpërdrejt ndaj paditëses, e kryer nga ana e palës së paditur Shoqërisë Albpetrol sh.a Fier.
2. Detyrimin e palës së paditur Shoqërisë Albpetrol sh.a Fier, të dëmshpërblejë paditëse për dëmin pasuror dhe jopasuror të pësuar në masën 5.268.903 lekë.
3. Detyrimin e palës së paditur Shoqërisë Albpetrol sh.a Fier, të paguaje shpenzimet Gjyqësore dhe ato të përfaqësimit me avokat.



RR 098 510 561 AA

**BAZA LIGJORE:**

Nenet 17/2, 18, 33/1, 42, 44 dhe 49 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Neni 14 i Konventës Europiane të të Drejtave të njeriut, Neni 31, 32/a, 153, 154 të K.Pr.Civile, Nenet 9, 10, 10/1 i Kodit të Punës, Nenet 3, 7, 12, 13, 34, 36, 37, 38 të Ligjit Nr.10021 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", si dhe Nenet 608, 609, 625, 640 të Kodit Civil; Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë Tiranë Nr.12 datë 14.09.2007, Vendim i Gjykatës Kushtetuese Nr.6, datë 17.02.2012.

**Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin Nr.313 (1235), datë 08.03.2018 ka vendosur:**

- ❖ Pranimin e kërkesë-padisë.
- ❖ Detyrimin e palës se paditur Shoqërisë Albpetrol sh.a të dëmshpërblejë palën paditëse:
  - [REDAKTUAR] për dëmin pasuror ne masën 2.856.103 (dy milion e tetëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e tre) lekë.
  - [REDAKTUAR] për dëmin jo pasuror (biologjik, moral, ekzistencial) në masën 2.412.800 lekë (dy million e katërqind e dymbëdhjetë mijë e tetëqind) lekë.
- ❖ Shpenzimet Gjyqësore ne ngarkim te palës se paditur Shoqërisë Albpetrol sh.a.
- ❖ Për këtë vendim lëshohet urdhër ekzekutimi.
- ❖ Bashkëlidhur me këtë vendim urdhri i ekzekutimit.

**Kundër këtij vendimi në bazë të nenit 452 e vijues të K.Pr.Civile ka paraqitur ankim pala e paditur Shoqëria "Albpetrol" sh.a, e cila ka kërkuar ndryshimin e të tij dhe rrëzimin e padisë, duke parashtruar se:**

- Vendimi është i pabazuar në prova dhe në ligj. Është provuar gjatë gjykimit se zgjidhja e marrëdhënies së punës së paditëses është bërë konform Kodit të Punës. Vendi i punës së paditëses është mbyllur dhe për këtë shkak pala e paditur ka ndjekur të gjitha procedurat e parashikuara nga Kodi i Punës, duke filluar nga njoftimi për mbajtjen e takimit, procesverbali i takimit i datës 05.03.2015 si dhe ka respektuar afatin 3 mujor të takimit. Theksojmë se marrëdhënia e punës nuk është bërë në mënyrë të menjëhershme dhe për shkaqe abuzive apo diskriminuese të pretenduara në kuptim të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010, por është respektuar procedura sipas ligjit në fuqi.
- Pala e paditur ka bërë kallëzim penal ndaj paditëse dhe Prokuroria e Rrethit Fier ka vendosur "Mosfillimi i procedimit penal".
- Komisioni për Mbrojtjen nga diskriminimi, pas hetimit ka dalë me vendimin nr.221, datë 30.12.2016 ku ka konstatuar se pretendimet e zonjës Liljana Manajja në pjesërisht të bazuara dhe për këtë ka vendosur ndër të tjera: "Konstatimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë të ankueses, [REDAKTUAR], për shkak të gjinisë nga ana e punëdhënësit Albpetrol SHA, Patos. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankueses, për shkak të bindjeve politike nga punëdhënësi Albpetrol sh.a, Patos. Rikthimin e saj në vendin e punës". Këtë vendim Komisioni e ka bazuar në nenet 1 dhe 3 të ligjit 10221, datë 04.02.2010. Pala e paditur e ka kontestuar këtë vendim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për shkak se vendimi është i pabazuar në prova dhe në ligj. Për më tepër rikthimi në vendin e mëparshëm të punës është akt absolutisht i pavlefshëm për shkak se është në kundërshtim dhe me kërkesat e nenit 146 të K.Punës. Në bazë të

kësaj dispozite rikthimi në punë lejohet kur plotësohen në mënyrë kumulative dy kriteret: i) *punëmarrësi të jetë punonjës i administratës shtetërore;* ii) dhe vetëm kur ka një vendim gjykatë. Në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me asnjë prej rasteve të mësipërme.

- Në rastin e konstatimit të akteve të diskriminimit, i vetmi sanksion që mund të jepet nga Gjykata ndaj punëdhënësit është dëmshpërblimi deri një vit pagë.
- Akti administrativ nr.211, datë 30.12.2016 i Komisionerit duhet të shpallet si akt absolutisht i pavlefshëm për pjesën që ka urdhëruar kthimin e paditëses në vendin e punës, pasi nuk është mbështetur në asnjë dispozitë ligjore. Akti nuk përputhet me përmbajtjen e ligjit. Në këto kushte në bazë të nenit 108 të K.Pr.Administrative kur një akt është nxjerrë në kapërxim të kompetencave ligjore duhet të shpallet si absolutisht i pavlefshëm.
- Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka rrëzuar padinë. Duke e vlerësuar këtë vendim si të padrejtë e kemi kundërshtuar në Gjykatën e Apelit Administrativ. Për këtë shkak kërkuam pezullimin e gjykimit dhe gjykata e faktit me pa të drejtë rrëzoi kërkesën tonë. Nuk është provuar akoma me vendim të formës së prerë nëse kemi diskriminim apo jo, shkak ky që duhet ta detyronte gjykatën të pezullonte gjykimin.
- Gjykata nuk ka mbajtur parasysh kërkesat e neneve 1, 3, 7, 12, 34 dhe 36 të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010. Është detyrim i paditësit të sjellë prova në mbështetje të padisë. Paditësja nuk paraqiti asnjë provë për të provuar diskriminimin e saj.
- Nuk jemi dakort me konkluzionet e aktit të vlerësimit psikologjik. Gjendja shëndetësore e përshkruar në aktin psikologjik ka qenë e tillë para largimit të saj nga puna.
- Po kështu nuk jemi dakort me aktin e vlerësimit të dëmit shëndetsor. Ky bie në kundërshtim me kartelën mjekësore të paditëses të cilat provojnë të kundërtën e asaj që pretendon paditësja. Përcaktimi prej ekspertit i shkallës së paaftësisë në masën 25% është i pabazuar, pasi ky veprim kapërxen kompetencat e Ekspertit Vlerësues të Dëmeve Shëndetsore. Shkalla e paaftësisë përcakohet nga komisioni mjekësor i caktimit të aftësisë për punë (KMCAP).
- Gjykata ka lejuar shkelje procedurale. Duke qenë se vlera e padisë është me vlerë mbi 50 milionë lekë gjykimi duhet të bëhet me trup gjykues me tre gjyqtarë. Vlera e padisë është 5.268.903 lekë.
- Përfundimisht kërkojmë ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e padisë ose në alternativë prishjen e tij dhe kthimin e çështjes për rigjykim.

**Kundër këtij vendimi në bazë të nenit 452 e vijues të K.Pr.Civile ka paraqitur ankim dhe Avokatura e Shtetit Zyra Vendore Vlorë, e cila ka kërkuar ndryshimin e tij dhe rrëzimin e padisë, duke parashtuar se:**

- **Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier është i pabazuar në prova dhe në ligj, prandaj më poshtë po paraqesim shkaqet përse kërkojmë ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e padisë.**
- **Për asrye logjistike dhe për shkak të ngarkesës po dorëzojmë këtë ankim të shkurtuar duke paraqitur në mënyrë të përmbledhur shkaqet. Vendimi është marrë në kundërshtim me ligjin material dhe procedural. Gjithashtu objekti i padisë nuk i qëndron fakteve dhe provave si dhe kërkimeve të bëra në proces nga palët.**

- I bëjmë me dije Gjykatës së Apelit se në mbështetje me të drejtat procedurale rezervojmë të drejtën që në një moment të dytë të paraqesim ankimin e plotë me shkaqet ligjore.
- Përfundimisht kërkojmë ndryshimin e vendimit gjyqësor nr.313, datë 08.03.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe rrëzimin në tërësi të padisë.

### GJYKATA E APELIT VLORE:

- Pasi dëgjoji, relativin e çështjes nga gjyqtar **Hysen SALIKO**;
- Përfaqësuesin e palës së paditur Shoqëria "Albpetrol" sh.a, juristen [REDAKTUAR] që kërkoj ndryshimin e vendimit Nr.313, datë 08.03.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe duke gjykuar çështjen në fakt, rrëzimin e padisë dhe shpenzimet gjyqësore t'i ngarkohen paditëses;
- Në mungesë paditëses [REDAKTUAR], të Personit të Tretë dhe Avokaturës së Shtetit;
- Dhe si e shqyrtoi dhe e bisedoi çështjen në tërësi,

### V Ë R E N:

Se vendimi Nr.313, datë 08.03.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, është i bazuar në ligj dhe në prova dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi.

#### Rrethanat e faktit:

1. Pala paditëse [REDAKTUAR], ka qenë punëmarrëse pranë Shoqërisë Albpetrol sh.a me detyrë "shefe finance" (për më tepër shih Kontratën Individuale Nr.650/209 Prot datë 01.08.2014), dhe marrëdhënia e saj e punës ka përfunduar për shkaqe që nuk lidhen me detyrimet kontraktuale të palës paditëse, e në vijim duke u konsideruar zgjidhja kontratës si e menjëhershme dhe e pajustificuar. Referuar Vendimit Nr.250 datë 10.03.2015 rezulton se, Shoqëria Albpetrol ka vendosur zgjidhjen e Kontratës së punës për Znj [REDAKTUAR], si pasojë e ristrukturimit të Drejtorisë së Financës së Shoqërisë Albpetrol sh.a.
2. Referuar Vendimit "Për mosfillimin e procedimit penal" rezulton se, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier mbi kallëzimin penal Nr.733, datë 26 Prill 2016 të Shoqërisë Albpetrol sh.a për veprën penale të "Shpërdorimit të detyrës" parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, ka disponuar konkretisht: "Mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin Nr.733 te vitit 2016", për shkak të mungesës së elementëve materialë të figurës së veprës penale të "Shpërdorimit të detyrës".
3. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nëpërmjet Vendimit Nr.211 datë 30.12.2016, ka marrë në shqyrtim Ankesën nr.48 datë 23.05.2016 të palës paditëse, nëpërmjet të cilës pretendohet diskriminim për shkak të "bindjeve politike"; "gjinisë"; "gjendjes civile".
4. Referuar Shkresës datë 05.12.2016 rezulton se, pala paditëse [REDAKTUAR] ka punuar si specialiste, llogaritare për periudhen nga data 20.02.2002 deri me 30.09.2004 pranë Degës së Partisë Demokratike Mallakastër, me pagë bruto 8500 lekë dhe page neto 7584 lekë. Gjithashtu, në gjykim është administruar Librezja e Anëtarësisë së palës paditëse [REDAKTUAR] pranë Partisë Demokratike, Karta e Anëtarësisë së Komisionit të Zonës Zgjedhore Nr.73.

5. Referuar Shkresës Nr.5464Prot datë 29.07.2016 rezulton se, pala e paditur Shoqëria Albpetrol sh.a ka parashtruar përpara Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi se, para fillimit të procesit të ristrukturimit financiar, Shoqëria Albpetrol sh.a ka pasur në përbërje të strukturave organizative të saj 9 (nëntë) pozicione pune me emërtimin "Shef Finance". Pas miratimit të Vendimit Nr.3, datë 19.02.2016 të Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë Albpetrol sh.a, nga 9 (nente) pozicione të tilla 8 (tete) u suprimuan duke mbetur vetëm një pozicion pune Shef Finance në Q.A.SH.N.G Patos. Pas ristrukturimit financiar, humbën vendin e punës si pasojë e këtij suprimi znj. [REDAKTUAR] dhe znj. [REDAKTUAR], ndërkohë që punonjësit e tjerë të mbetur u transferuan në pozicione të tjera pune të kategorisë më të ulët. Sipas, palës se paditur në periudhën përkatëse nuk ka qenë i mundur sistemi i saj prane Q.P.N. Ballsh në pozicion tjetër pune që përputhej me arsimin e saj të lartë "Ekonomi Agro-Biznesit" pasi gjatë kohëzgjatjes së afatit të njoftimit Q.P.N. Ballsh ka pasur vetëm dy vende vakante "Operator Prodhimi". Lidhur me numrin e punonjësve të tjerë që kanë pasur pozicion pune paralel me znj. [REDAKTUAR] pala e paditur ka parashtruar se, janë sistemuar gjashtë punonjës në vende pune. Ndërkohë, referuar Shkresës Nr.3994/1 Prot datë 24.06.2016 rezulton se, pala e paditur Shoqëria Albpetrol sh.a ka parashtruar përpara Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi se, marrëdhëniet e punës me palën paditëse [REDAKTUAR] janë ndërprerë bazuar në Vendimin Nr.3, datë 19.02.2016 të Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë Albpetrol sh.a, në të cilin vendi i punës "Shef Finance", është shkurtuar në strukturën e qëndrave përbërëse të Shoqërisë Albpetrol sh.a.
6. Referuar Vendimit Nr.3 datë 09.01.2015 të Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë Albpetrol sh.a, rezulton se është konkluduar me miratimin e shtesës në strukturën administrative, ndryshime të cilat do të kryhen brenda numrit të miratuar të punonjësve Albpetrol sh.a.
7. Nëpërmjet Vendimit Nr.211 datë 30.12.2016, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka konkluduar: *"1-Konstatimin e diskriminimit të drejtëpërdrejtë të ankueses, [REDAKTUAR], për shkak të gjinisë nga ana e punëdhënësit Albpetrol SHA, Patos. 2- Konstatimin e mosdiskriminimit të ankueses, për shkak të bindjeve politike nga punëdhënësi Albpetrol sh.a, Patos. 3-Detyrimin e Shoqërisë Albpetrol SHA, Patos, të kthejë në mënyrë të menjëhershme në punë ankuesen. 4-Detyrimin e Shoqërisë Albpetrol SHA, Patos, të informojë brenda 30 (tridhjetë) ditëve Komisionerin lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi, bazuar në nenin 33, pika 1 e Ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi". 5-Në referim të nenit 33, pika 11 e ligjit nr.10221, datë 04.02.2010, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikime të bëra në pikën 13 të po këtij neni. 6-Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, brenda 15 ditëve, duke filluar ky afat nga dita e nësërme e komunikimit të këtij vendimi."*
8. Mbi këto rrethana fakti pala paditëse [REDAKTUAR] i është drejtuar fillimisht Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë duke kërkuar shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor, dëmin pasuror dhe jopasuror të shkaktuar, si pasojë e zgjidhjes së marrëdhënies së punës për shkak të diskriminimit.
9. Gjykatë Administrative e Shkallës së Parë Vlorë me vendimin nr.437, datë 29.03.2017 ka vendosur: *"Deklarimin e moskompetencës lëndore për shqyrtimin e çështjes civile me nr.745 Akti, datë regjistrimi 06.03.2017. Dërgimin e akteve Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, si gjykatë kompetente".* Meqënëse vendimi nuk

u ankimua, aktet janë dërguar pranë Gjykatës kompetente për shqyrtim.

10. Pra, paditësja, pretendon se bazuar në Kushtetutën e R.SH. nenin 15 i saj; nenin 608 e në vijim; 625 e 640; 641 e në vijim të Kodit Civil, i padituri është përgjegjës objektivisht dhe civilisht, për dëmin që iu është shkaktuar si pasojë e ligjit të posaçëm që rregullon juridikisht këtë situatë.
11. Në seancën e datës 26.02.2018 nga ana e palës paditëse është paraqitur në gjykim kërkesë për shtim objekti referuar nenin 185 të Kodit të Procedurës Civile, kërkesë e cila është pranuar nga gjykata me vendim të ndërmjetëm, referuar parashikimit ligjor në nenin 185 të Kodit të Procedurës Civile.
12. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, pasi ka kryer një hetim të plotë e të gjithanshëm, ka kryer akt-ekspertimi për vlerësimin e dëmit në respektim të kërkesave të nenit 224/a e vijues të K.Pr.Civile dhe pasi ka dëgjuar palët në konkluzionet përfundimtarë, në përfundim ka pranuar padinë, si të mbështetur në ligj dhe në prova.
13. *Me vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Fier nuk kanë qenë dakort pala e paditur Shoqëria "Albpetrol" sh.a dhe Avokatura e Shtetit Zyra Vendore Vlorë, të cilët brenda afatit kanë ushtruar ankim pranë kësaj Gjykate dhe kërkojnë ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e padisë ose në alternativë kthimin e çështjes për rigjykim, duke parashtruar si shkaqe, konkretisht ato që janë përmendur në pjesën hyrëse të këtij vendimi.*

#### **Vlerësimi i Gjykatës së Apelit:**

14. Gjykata e Apelit e shqyrton çështjen në Shkallë të Dytë mbi ankimin e palës së paditur Shoqëria "Albpetrol" sh.a dhe Avokaturës së Shtetit, të cilat kanë pretenduar për zbatim të gabuar të ligjit material nga gjykata e faktit.
15. Gjykata e Apelit çmon se shkaqet e ngritura në ankimin e palës së paditur janë të pambshtetura në ligj, duke konkluduar se gjykata e faktit ka zbatuar në mënyrë të drejtë ligjin material dhe procedural, duke dhënë një vendim të bazuar në provat e shqyrtuara dhe administruara në seancë gjyqësore.
16. Në lidhje me legjitimitetin e palës paditëse në ngritjen e padisë, Gjykata e Apelit çmon se paditësja në këtë gjykim legjitimohet plotësisht në kërkimet e saj sipas objektit të padisë, pasi ajo ka një interes të ligjshëm për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të kërkuar prej saj realizimin e së drejtës, në referim të nenin 34 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", të neneve , 608, 609, 625 e 640 të Kodit Civil si dhe të vendimit Unifikues të Gjykatës së Lartë nr.12 datë 14.09.2007, ndërsa pala e paditur ka legjitimitet pasiv, në cilësinë e punëdhënësit të paditëses që ka zgjidhur kontratën e punës në mënyrë të njëanshme, zgjidhje e cila pretendohet nga paditësja se është bërë për motiv abuziv, pra për shkak të diskriminimit.
17. Në nenin 34 të Ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 i titulluar "Subjektet që kanë të drejtë të paraqesin padi për diskriminim", është përcaktuar se: "1. Çdo person ose grup personash që pretendojnë se ndaj tyre është ushtruar diskriminim për një nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, mund të paraqesin kërkesëpadi përpara gjykatës kompetente sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile për dëmshpërblim sipas ligjit ose, sipas rastit, të kryejnë kallëzimin përpara organeve

kompetente për ndjekje penale. 2. Paraqitja e ankimit përpara komisionarit nuk është kusht për të paraqitur një kërkesëpadi dhe nuk përbën pengesë për personin e dëmtuar t'i drejtohet gjykatës ose organeve të ndjekjes penale. 3. Një organizatë me interes të ligjshëm ose komisionari mund të paraqesë padi në emër të një personi ose grupi personash, me kusht që komisionari ose organizata të ketë pëlqimin me prokurë të posaçme ose me deklaram përpara gjykatës të personit ose grupit të personave të dëmtuar nga diskriminimi". Në këtë dispozitë të këtij ligji janë përcaktuar subjektet, mjetet procedurale si dhe procedurat apo kërkesat ligjore që ka parashikuar ligji, në mënyrë që çdo personi i cili pretendon se është diskriminuar, të ketë mundësi për tu mbrojtur dhe për ti krijuar: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin si dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit të shkaktuar si pasojë e diskriminimit.

18. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me Vendimin Unifikues nr.12 datë 14.09.2007 kanë konkluduar se: "Çdo subjekt i cënuar në të drejta dhe interesa të ligjshme personale e pasurore, nga fakti i paligjshëm, edhe nëse nuk është ai vetë subjekti pasiv i atij fakti, ka të drejtën subjektive, legjitimimin aktiv, për të kërkuar (ius proprius) dëmshpërblimin e dëmit pasuror e jopasuror të pësuar.". Paditësja në këtë gjykim, është vetë e dëmtuara nga akti i paligjshëm dhe për pasojë gëzon legjitimimin aktiv.
19. Gjykata e Apelit çmon gjithashtu se, edhe pse e drejta e paditëses për të ngritur padinë objekt gjykimi për kërkimin e dëmshpërblimit si pasojë e diskriminimit, parashikohet në mënyrë të posaçme nga një dispozitë e veçantë ligjore (neni 34 i ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi") në thelb mosmarrëveshja objekt gjykimi është një mosmarrëveshje për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor që gjen rregullim nga nenet 608, 609, 625 dhe 640 të Kodit Civil, dhe me të drejtë Gjykata e shkallës së parë e ka cilësuar si të tillë në përputhje të plotë me nenin 16 të KPrCivile.
20. Gjykata e Apelit pasi analizoi shkaqet e ngritura në ankimin e palës së paditur çmon se drejt ka vepruar gjykata e shkallës së parë edhe në lidhje me dëmshpërblimin dhe masën e saj, njëherazi dhe me ligjin e aplikueshëm. Paditësja e ka mbështetur të drejtën e saj të pretenduar në nenin 608 të Kodit Civil, në të cilin parashikohet se: "Personi që në mënyrë të paligjshme dhe me faj i shkakton tjetrit një dëm në personin dhe pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar". Kjo dispozitë parashikon faktin juridik njerëzor të sjelljes së paligjshme dhe me faj të një personi fizik apo juridik (që në rastin konkret pretendohet se është shoqëria Albpetrol sh.a.), që i shkakton dëm një personi tjetër. Nëse vërtetohet fakti i paligjshëm dhe lidhja shkakësore e tij me dëmin, lind marrëdhënia e detyrimit, e drejta subjektive e personit të dëmtuar për të kërkuar dëmshpërblim dhe detyrimi i personit përgjegjës për ta shlyer atë. Në interpretim të kësaj dispozite, për të vërtetuar se nga veprimet apo mosveprimet e palës së paditur, i është shkaktuar dëm jashtëkontraktor palës paditëse, duhet detyrimisht të vërtetohet nga ana e palës paditëse, që pretendon se është dëmtuar, kryerja e veprimeve në mënyrë të paligjshme dhe me faj.
21. Në interpretim të kërkesave të dispozitave të sipërcituara, për t'u legjitimuar në kërkimin e tyre duhet që paditësja të provoj se është konsumuar fakti i paligjshëm në të tre elementët objektive e subjektive të tij: ngjarja e dëmit nga sjellja e paligjshme

(non jure) dhe me faj (culpa) e të tretit, si dhe shkaktimi i dëmtimit prej kësaj ngjarje. Në rastin konkret, fakti i paligjshëm nga i cili pretendohet se ka ardhur dëmi i shkaktuar paditëses është diskriminimi. Në nenin 3, pika 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 është dhënë definicioni mbi diskriminimin, në të cilin është pasqyruar se: "1. "Diskriminimi" është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi", ndërsa në nenin 1 të tij parashikohet se ky ligj mbron subjektet nga diskriminimi i bazuar në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër. Më tej, në nenin 36 po të këtij ligji, i titulluar "Procedura para gjykatës" është parashikuar se: "1. Padia i paraqitet gjykatës kompetente nga një prej subjekteve të parashikuara në nenin 34 të këtij ligji jo më vonë se 5 vjet nga dita që ka ndodhur sjellja e pretenduar diskriminuese dhe jo më vonë se 3 vjet nga dita që i dëmtuari merr dijeni për këtë sjellje. 2. I dëmtuari nuk ka detyrim të njoftojë komisionarin para se të paraqesë një padie për diskriminim në gjykatë. 3. Gjykata e njofton komisionarin për paraqitjen e çdo padie për diskriminim. 4. Gjykata mund t'i kërkojë komisionarit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen. 5. Paditësi ka detyrim të sjellë prova në mbështetje të padisë, duke përdorur çdo lloj prove të ligjshme që mund të provojë sjelljen diskriminuese. 6. Pasi paditësi paraqet prova, mbi të cilat bazon pretendimin e tij dhe në bazë të të cilave gjykata mund të prezumojë sjelljen diskriminuese, i padituri detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim sipas këtij ligji".

22. Në analizë të dispozitave ligjore të cituara më sipër, rezulton qartësisht se, barrën e provës për të provuar ekzistencën e diskriminimit e ka subjekti i cili ka ngritur pretendimin se është diskriminuar. Nga tërësia e provave të administruara në gjykim, është provuar se paditësja [REDAKTUAR] ka qenë punëmarrëse pranë Shoqërisë Albpëtrrol sh.a me detyrë "shefe finance" (për më tepër shih Kontratën Individuale Nr.650/209 Prot datë 01.08.2014), dhe marrëdhënia e saj e punës ka përfunduar për shkaqe që nuk lidhen me detyrimet kontraktuale të palës paditëse, e në vijim duke u konsideruar zgjidhja kontratës si e menjëhershme dhe e pajustificuar. Referuar Vendimit Nr.250 datë 10.03.2015 rezulton se, Shoqëria Albpëtrrol ka vendosur zgjidhjen e Kontratës së punës për Znj. [REDAKTUAR], si pasojë e ristrukturimit të Drejtorisë së Financës së Shoqërisë Albpëtrrol sh.a.
23. Referuar Shkresës Nr.5464 Prot datë 29.07.2016 rezulton se, pala e paditur Shoqëria Albpëtrrol sh.a ka parashtruar përpara Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi se, para fillimit të procesit të ristrukturimit financiar, Shoqëria Albpëtrrol sh.a ka pasur në përbërje të strukturave organizative të saj 9 (nëntë) pozicione pune me emërtimin "Shef Finance". Pas miratimit të Vendimit Nr.3, datë 19.02.2016 të Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë Albpëtrrol sh.a, nga 9 (nente) pozicione të tilla 8 (tetë) u suprimuan duke mbetur vetëm një pozicion pune Shef

- Finance në Q.A.SH.N.G Patos. Pas ristrukturimit financiar, humbën vendin e punës si pasojë e këtij suprimi znj. [REDAKTUAR] dhe znj. [REDAKTUAR], ndërkohë që punonjësit e tjerë të mbetur u transferuan në pozicione të tjera pune të kategorisë më të ulët. Sipas, palës së paditur në periudhën përkatëse nuk ka qenë i mundur sistemi i saj prane Q.P.N. Ballsh në pozicion tjetër pune që përputhej me arsimin e saj të lartë "Ekonomi Agro-Biznesit" pasi gjatë kohëzgjatjes së afatit të njoftimit Q.P.N. Ballsh ka pasur vetëm dy vende vakante "Operator Prodhimi". Lidhur me numrin e punonjësve të tjerë që kanë pasur pozicionin paralel me znj. [REDAKTUAR] pala e paditur ka parashtruar se, janë sistemuar gjashtë punonjës në vende pune. Ndërkohë, referuar Shkresës Nr.3994/1 Prot datë 24.06.2016 rezultoi se, pala e paditur Shoqëria Albpetrol sh.a ka parashtruar përpara Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi se, marrëdhëniet e punës me palën paditëse [REDAKTUAR] janë ndërprerë bazuar në Vendimin Nr.3, datë 19.02.2016 të Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë Albpetrol sh.a, në të cilin vendi i punës "Shef Finance", është shkurtuar në strukturën e qendrave përbërëse të Shoqërisë Albpetrol sh.a.
24. Referuar Vendimit Nr.3 datë 09.01.2015 të Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë Albpetrol sh.a, rezultoi se është konkluduar me miratimin e shtesës në strukturën administrative, ndryshime të cilat do të kryhen brenda numrit të miratuar të punonjësve Albpetrol sh.a.
25. Nëpërmjet Vendimit Nr.211 datë 30.12.2016, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka konkluduar: "1-Konstatimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë të ankuases, [REDAKTUAR], për shkak të gjinisë nga ana e punëdhënësit Albpetrol SHA, Patos. 2- Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuases, për shkak të bindjeve politike nga punëdhënësi Albpetrol sh.a, Patos. 3-Detyrimin e Shoqërisë Albpetrol SHA, Patos, të kthejë në mënyrë të menjëhershme në punë ankuesen. 4-Detyrimin e Shoqërisë Albpetrol SHA, Patos, të informojë brenda 30 (tridhjetë) ditëve Komisionerin lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi, bazuar në nenin 33, pika 1 e Ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi". 5-Në referim të nenit 33, pika 11 e ligjit nr.10221, datë 04.02.2010, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikime të bëra në pikën 13 të po këtij neni. 6-Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, brenda 15 ditëve, duke filluar ky afat nga dita e nësërme e komunikimit të këtij vendimi."
26. Në këtë pikë, Gjykata e Apelit e çmon të drejtë qëndrimin e Gjykatës së shkallës së parë, se në rastin konkret vendimi i Komisionerit, pavarësisht nëse ka pranuar apo rrefuzuar kërkesën, nuk është detyruar për gjykatën, pasi Gjykata e shqyrton çështjen në themel në bazë të rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile, ku vendimi i Komisionerit apo mendimi (nëse nuk është paraqitur paraprakisht ankesë pranë Komisionerit), do të vlerësohen në raport me të gjitha provat e tjera të paraqitura nga palët dhe që i janë nënshtruar hetimit Gjyqësor.
27. Në lidhje me sa më sipër, Gjykata e Apelit vlerëson se në çështjen konkrete, vërtetohet plotësisht fakti i paligjshëm, pasi rezultoi se pala paditëse [REDAKTUAR] është larguar nga puna në mënyrë të menjëhershme, të pajustificuar, ndërkohë që janë shtuar edhe pesë punonjës në organikë, dhe janë transferuar të gjithë punonjësit e tjerë të gjinisë mashkullore nga pozicioni "shef finance". Në gjykimin e palës së paditur Shoqëria Albpetrol sh.a nuk provoi kriteret e ndjekura në lidhje me transferimin e gjashtë punonjësve nga pozicioni "shef finance" në një pozicion tjetër, si dhe punësimin e pesë punonjësve si "specialist prokurimesh". Gjithashtu,

nuk provoi motivin apo shkakun pse nuk i është ofruar një pozicion pune në kohën e transferimit apo punësimit palës paditëse [REDACTED]

28. Për sa më sipër Gjykata e Apelit vlerëson se është i drejtë konstatimi i Gjykatës së shkallës së parë se, veprimet e palës së paditur Shoqërisë Albpetrol sh.a përbëjnë diskriminim të drejtëpërdrejtë në lidhje me palën paditëse [REDACTED]
29. Gjykata e Apelit, thekson edhe njëherë se duke iu referuar përcaktimeve të nenit 609 të Kodit Civil, për pranimin e përgjegjësisë civile jashtëkontraktore, duhet të vërtetohet lidhja shkakësore materiale ndërmjet sjelljes (veprimit a mosveprimit) të paligjshëm dhe me faj dhe dëmit të shkaktuar. Në vijim, për përcaktimin e dëmtimeve konkrete që rrjedhin nga ky fakt i paligjshëm dhe caktimin e dëmshpërblimit përkatës, duhet të vërtetohet edhe lidhja shkakësore juridike ndërmjet tyre. Nëpërmjet lidhjes shkakësore materiale, vërtetohet se cili është personi përgjegjës (*subjekti aktiv*) dhe lidhja shkak-pasojë ndërmjet tre elementeve objektive e subjektive të faktit të paligjshëm (ngjarjes së dëmit): sjelljes së paligjshme (*objektiv*) dhe me faj (*subjektiv*) dhe pasojës së ardhur prej tyre, pra dëmtimit të një tjetri në personin ose pasurinë e tij (*objektiv*). Në këtë rast zbatohet parimi juridik *condicio sine qua non*, sipas të cilit, ardhja e pasojës së dëmshme nuk do të vërtetohej nëse nuk do të kishte ndodhur shkak, sjellja e paligjshme dhe me faj e personit përgjegjës për shkaktimin e dëmit. Ndërsa, me lidhjen shkakësore juridike vërtetohet lidhja shkak-pasojë ndërmjet faktit të paligjshëm në tërësinë e tij dhe çënimeve konkrete të pësura në të drejta dhe interesa të ligjshme, si të subjektit pasiv mbi të cilin ka vepruar direkt ky fakt i paligjshëm, ashtu edhe të personave të tjerë që rezultojnë të dëmtuar si rrjedhojë e pasojave që pranohet se vijnë normalisht dhe zakonisht nga i njëjti fakt i paligjshëm, sipas parimeve të rregullshmërisë dhe efikasitetit të lidhjes shkakësore. Në çështjen objekt gjykimi, rezulton se vërtetohet lidhja shkakësore materiale ndërmjet sjelljes së paligjshme e me faj të punëdhënësit Albpetrol sh.a dhe pasojës së kësaj ngjarjeje dëmi, shkaktimi i dëmit pasuror dhe jopasuror.
30. Nga ana tjetër, në lidhje me kërkesën për dëmshpërblim, në nenin 608 të K.Civil dhe atë të nenit 34 të Ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", të nëneve, si dhe në vendimin Unifikues të Gjykatës së Lartë nr.12 datë 14.09.2007, ligjëvendësi parashikon mbrojtjen nga fakti i paligjshëm i të drejtave të njeriut, posaçërisht të të drejtave subjektive (absolute ose relative) të personalitetit dhe të pronësisë (reale), sikurse janë e drejta e jetës, shëndetit, personalitetit, dinjitetit, familjes, jetës private, pronës, etj. Në rast të çënimit të këtyre të drejtave nga fakti i paligjshëm, i dëmtuari gëzon të drejtën subjektive relative të kërimit të dëmshpërblimit jashtëkontraktor pasuror dhe jopasuror.
31. Gjykata e Shkallës së Parë Fier, pasi ka analizuar të gjitha rrethanat e faktit dhe ka analizuar shkaqet ligjore të kërimeve të ngritura në padi por dhe në referim të nëneve 16 dhe 28 të K.Pr.Civile; pasi ka konkluduar se paditëses i përket shpërblimi si pasojë e diskriminimit, për faktin se e dëmtuara ka humbur aftësinë për punë edhe në të ardhmen.
32. Gjykata e Apelit çmon se konkluzioni i arritur nga Gjykata e Shkallës së Parë Fier është i drejtë dhe i mbështetur në ligj e në prova për sa i përket vlerës së dëmit pasuror dhe jopasuror, ndërsa shkaqet e ngritura në ankim nga pala e paditur, konsiderohen të pambështetura në ligj. Ato në tërësinë më të madhe kanë marrë zgjidhje në arsyetimin e vendimit objekt ankimi. Kjo për faktin se në shqyrtimin e

çështjes Gjykata e Shkallës së Parë, ka vlerësuar masën e dëmit, në kuptim të neneve 608, 640, 646 të Kodit Civil, vendimi unifikues të Gjykatës së Lartë, elementët e dëmit të shkaktuar, si dhe vlerën provuese, të akteve zyrtare të lëshuar nga ana e institucioneve.

33. Gjykata e Shkallës së Parë Fier, pasi ka analizuar të gjitha rrethanat e faktit dhe ka analizuar shkaqet ligjore të kërtimeve të ngritura në padi por dhe në referim të neneve 16 dhe 28 të K.Pr.Civile; pasi ka konkluduar se paditëses i përket shpërblimi, për faktin se paditësja vetë si e dëmtuar ka pësuar dëm pasuror dhe jo pasuror nga fakti i paligjshëm; pasi ka vlerësuar se ajo legjitimohet të kërkoj dëmshpërblimin e dëmit pasuror dhe jopasuror, dhe, me të drejtë për të bërë vlerësimin e dëmit pasuror dhe jopasuror, në zbatim të kërkesave të neni 224/a e vijues të K.Pr.Civile, ka thirrur sikundër përmendëm më sipër një ekspert të vlerësimit të dëmeve dhe njëherazi dhe ekspert psikolog.
34. Nga ana e Gjykatës së faktit është bërë fillimisht vlerësimi për dëmin pasuror të shkaktuar paditëses. Dëmi pasuror sjell si pasojë cenimin e pasurisë së të dëmtuarit në kuptimin e ngushtë ekonomik, pra humbjen e pasurisë (*deminutio patrimonii*) në mënyrë të paligjshme. Prandaj edhe dëmshpërblimi i dëmit pasuror ka për qëllim të rikthejë pasurinë e të dëmtuarit në gjendjen e mëparshme, duke "mbushur" diferencën e krijuar ndërmjet gjendjes ekonomike aktuale të tij me atë në të cilin do të ndodhej nëse nuk vërtetohej fakti i paligjshëm (*quanti ea res erit, tantam pecuniam condemnato*).
35. Sikurse ka rezultuar edhe gjatë gjykimit, paditësja Liljana Manaj, e cila në mbështetje të nenit 641 të K.Civil, duke patur parasysh shkallën e dëmtimeve të paktëshme e të përhershme që ajo ka pësuar në shëndet, të cilat kanë shkaktuar humbje të aftësisë për punë në masën 25%, ka kërkuar të dëmshpërblehet për dëmin pasuror në formën e shpenzimeve për mjekimin e saj si edhe shpenzimeve të tjera që kanë lidhje me dëmin e shkaktuar nga fakti i paligjshëm, referuar konstatimeve të ekspertit në aktin e ekspertimit vlerësues. Neni 641 i K.Civil parashikon se, kur shkaktohet dëmtimi në shëndetin e një personi, në llogaritjen e dëmit që duhet të dëmshpërblehet mbahet parasysh: "a) humbjen ose pakësimin e aftësisë për punë të të dëmtuarit; b) shpenzimet që janë bërë për mjekimin e tij; si edhe shpenzime të tjera që kanë lidhje me dëmin e shkaktuar".
36. Është provuar gjatë gjykimit se, paditësja ka humbur aftësinë për punë në masën prej 25% dhe ky fakt është provuar tërësisht dhe jashtë çdo dyshimi me provën shkencore të marrë në gjykim, e llojit më ekspert vlerësues i dëmeve të shkaktuara dhe njëkohësisht ekspert mjeko-ligjor. Referuar ekspertit si më sipër dëmtimet e konstatuara në shëndetin e paditëses konsistojnë në humbjen e aftësisë për punë. Referuar shkallës së humbjes së aftësisë për punë, paditësja, ka humbur mundësinë dhe të drejtën, për të gëzuar në jetesën e përditshme, si një njeri i shëndetshëm dhe i aftë për punë, për t'u kujdesur për vete dhe familjarët e saj. Me humbjen e aftësisë për punë në masën 25% në mënyrë të përhershme, paditësja nuk mund të vazhdojë të ketë të njëjtin nivel jetese dhe në të njëjtën shkallë me atë që gëzonte kur ishte një person i shëndetshëm dhe plotësisht i aftë për punë, pavarësisht se ajo nuk kryen punë fizike.
37. Ndryshe nga sa pretendohet në ankim prej palës së paditur, se janë kapërcyer kompetencat e Ekspertit Vlerësues të Dëmeve Shëndetsore pasi shkalla e paaftësisë përcakohet nga komisioni mjekësor i caktimit të aftësisë për punë (KMCAP), Gjykata e Apelit e vlerëson të drejtë përfundimin e ekspertit se paditësja

- ka humbur aftësinë për punë në masën prej 20%. Për të arritur në këtë konkluzion eksperti i caktuar prej Gjykatës ka vlerësuar në vijueshmëri gjendjen shëndetësore të paditëses, duke filluar nga momenti i shkaktimit të dëmit deri në momentin e kryerjes së eksertimit mjeko-ligjor prej tij. Për këtë qëllim ai (eksperti) është konsultuar me të gjitha provat shkresore të lejuara e marra gjatë këtij gjykimi si edhe ka kryer edhe ekzaminimin objektiv të paditëses.
38. Si përfundim duke ju referuar shkallës së humbjes së aftësisë për punë prej 25%, me të drejtë Gjykata konkludon se paditësja ka humbur mundësinë dhe të drejtën për të gëzuar në jetesën e përditshme, si një njeri i shëndetshëm dhe i aftë për punë, për t'u kujdesur për vete dhe familjarët e saj.
39. Sikurse arsyeton edhe gjykata e faktit, në rastin në gjykim jemi para kufizimit apo humbjes së aftësisë për punë, në masën 25%. Sipas një formule standarte përlllogaritje duke aplikuar edhe koeficientët përkatës të shumës së kapitalizuar, koeficientin e moshës së daljes në pension, dëmi pasuror i paditëses i llogaritur nga eksperti përputhet me rrethanat konkrete të çështjes, patur parasysh moshën e paditëses në momentin e aksidentit, dhe dëmtimet e përhershme të shkaktuara asaj në shëndet dhe është llogaritur kjo figurë e dëmit nga eksperti në shumën totale prej 2.856.103 lekë.
40. Po kështu drejt ka Gjykata e faktit edhe në lidhje përlllogaritjen e shpenzimeve farmaceutike dhe spitalore të parashikuara shprehimisht në nenin 641 të Kodit Civil. Shpenzimet farmaceutike e spitalore përbëjnë interesin e ligjshëm të cenuar në formën e pakësimit të pasurisë së personit, paditëses në rastin konkret, e cila i ka përballuar e vetme këto shpenzime. Këto shpenzime janë kryer si rrjedhojë e faktit të paligjshëm (largimit nga puna për si pasojë e diskriminimit) dhe për pasojë ato dëmshpërblehen bazuar në nenin e sipërcituar të Kodit Civil dhe ku përfshihen shpenzimet mjekime dhe medikamente të pasqyruara në aktet provuese.
41. Lidhur me dëmin jopasuror, në formën e dëmit biologjik, moral dhe ekzistencial, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë sqaruar dhe konkluduar duke njëjtësuar praktiken Gjyqësore se *"Dëmi jopasuror, i parashikuar në nenin 625 të Kodit Civil, si një kategori e gjere dhe gjithëpërfshirëse e dëmeve jashtëkontraktore, përfshin çdo lloj dëmi të pësuar nga cënimi i të drejtave dhe interesave jopasuror që bëjnë pjesë në vlerat e njeriut dhe që nuk janë subjekt vlerësimi të drejtpërdrejte ekonomik në treg. Në thelbin e saj, kjo dispozitë njih të drejtën e dëmshpërblimit për çdo lloj dëmi jopasuror jashtëkontraktor, i cili është "i ndryshëm nga ai pasuror". Renditja e "rasteve" të dëmit jopasuror në paragrafet "a" dhe "b" të saj, nuk ka për qëllim të kufizojë, por të rregullojë në mënyrë të shprehur, për efekt të dallueshmërisë së cënimeve, të drejtën e dëmshpërblimit përkatës dhe rrethin e subjekteve që të kërkojnë legjitimim aktiv."*
42. **Dëmi biologjik** i njohur në teori si dëmtimi i shëndetit, përbën në thelb cënimin e shëndetit dhe integritetit fizik e psikik të njeriut. Ky dëm përbën objekt kërkimi të pavarur nga dëmi pasuror e llojet e tjera të dëmit jopasuror dhe masa e dëmshpërblimit duhet t'i përafrohet shkallës konkrete të cënimit të përhershëm ose të përkohshëm të integritetit fizik ose psikik të të dëmtuarit. Në këtë kuptim, dispozita e nenit 625 të K. Civil bën dallimin ndërmjet dy grupeve të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut që nuk kanë natyrë pasurore të mbrojtura prej saj në rast cënimi: "dëmtimi i shëndetit" (e drejta absolute për shëndetin, në kuptimin biologjik) dhe cënimi i "personalitetit" (tërësia e të drejtave absolute të personalitetit). Nisur

nga natyra specifike e te drejtave qe mbrohen, ne paragrafin "a" dhe "b" te nenit 625, ligjvenesit ka parashikuar dy raste te posacme te demit jo-pasuror ne personalitetin e njeriut: "cënimi i ndërimit dhe "fyerja e kujtimit të një te vdekurf. Dëmtimi i shëndetit është figure autonome e demit jopasuror, e ndryshme nga demit pasuror per "humbjen dhe pakesimin e aftësisë për punë (neni 641 i K.Civil). dhe parashikohet nga një dispozitë e veçantë e K. Civil, posaçërisht në shkronjën "a" të nenit 625, ku thuhet se : "*Personi që pëson një dëm, të ndryshëm nga ai pasuror, ka të drejtë të kërkojë të dëmshpërblehet kur ...a) ka pësuar një dëmtim të shëndetit*".

43. Ky dëm jopasuror, i parashikuar nga shkronja "a" e nenit 625 te Kodit Civil, është objekt kerkimi dhe dëmshpërblimi i pavarur nga dëme të tjera pasurore e jopasurore të pësura nga i dëmtuari për shkak të njëjtit fakt të paligjshëm. Dëmi biologjik, duke qenë cënim në integritetin fizik dhe/ose psikik të njeriut, është objektivisht i vërtetueshem. Prandaj, ne zbatim te rregullave parimore te nenëve 2, 6, 29 e vijues të K.Pr.Civile (*da mihi factum, dabo tibi ius*), i dëmtuari që kërkon dëmshpërblimin ka barrën e provës të vërtetoje se dëmi ka ndodhur, si dhe lidhjen shkakësore të tij me faktin e paligjshëm. Referuar Aktit te Vlerësimit të demit te administruar ne gjykim rezulton se: "*Dëmi biologjik per palën paditëse [redacted] është ne masën 1.206.400 lekë.*"
44. Lidhur me dëmin moral, Gjykata e Apelit vëren se në vendimin unifikues nr.12/2007 Gjykata e Lartë është shprehur se: "*Dëmi moral është shfaqje e brendshme, e përkohshme, e turbullimit të padrejtë të gjendjes shpirtërore të njeriut, dhimbje e vuajtje shpirtërore apo gjendje ankthi e mundimi shpirtëror që rrjedh si pasojë e faktit të paligjshëm. Cilido që pëson cënime në sferën e shëndetit dhe të personalitetit të tij nga veprimet a mosveprimet e paligjshme dhe me faj të një të treti ka të drejtën të kërkojë edhe dëmshpërblimin e demit moral të pësuar. Kjo e drejtë, në cilësinë e të dëmtuarit, i përket individualisht edhe secilit prej familjarëve të afërt të personit që ka humbur jetën apo te cënuar në shëndetin e tij nga fakti i paligjshëm, nëse vërtetohet lidhja e tyre e posaçme familjare, ndjesore dhe e bashkejetesës. Dëmi moral i pësuar nga vetë të afërmit konsiderohet si pasojë, rrjedhim i menjëhershëm dhe i drejtpërdrejtë i të njëjtit fakt të paligjshëm*".
45. Dëmi moral (*pretium doloris ose pecunia doloris*) është shfaqje e brendshme, e përkohshme, e turbullimit te padrejte (non iure perturbatio) të gjendjes shpirtërore të njeriut, dhimbje e vuajtje shpirtërore apo gjendje ankthi e mundimi shpirtëror qe rrjedh si pasojë e faktit të paligjshëm. Cilido që pëson cënime në sferën e shëndetit dhe te personalitetit të tij nga veprimet a mosveprimet e paligjshme dhe me faj të një të treti ka të drejtën të kërkojë edhe dëmshpërblimin e demit moral të pësuar. Barra e provës për vërtetimin e demit moral është e paditësit. Por, nisur nga natyra subjektive e këtij demit dhe veçanërisht nga karakteri, shfaqja e brendshme e tij, vërtetimi i cënimit te personalitetit të të dëmtuarit ne turbullime, dhimbje e vuajtje shpirtërore, nuk mund te provohet në mënyrë tjetër përveçse duke i vlerësuar *ius receptum* si te mbështetura ligjërisht dhe duke i cmuar si te provuara *ipso iure* me vërtetimin nga paditësi të vetë faktit të paligjshëm të të paditurit dhe lidhjes se këtij fakti me cënimin moral të pësuar, sipas parimit të rregullshmërisë shkakësore. Duke qenë prove ne formën e prezumimit të thjeshtë, nëse shkakuesi i demit nuk arrin te vërtetoje të kundërtën, ajo merr të njëjtën vlerë e fuqi te plote provuese sikur se prezumimi ligjor iuris tantum (Neni 13 i K. Pr. Civile). Si përfundim i këtij

arsyetimi, Gjykata vlerëson se, masa e dëmshpërblimit për dëmin moral do të caktohet mbështetur në parimin e dhënies së drejtë, sipas bindjes së saj të brendshme të formuar nga shqyrtimi i të gjitha rrethanave të geshtjes në tërësi dhe tyre, duke u mbështetur edhe në kritere eventuale normative të zbatueshme sipas natyrës së të drejtës së cenuar ose, në mungesë të tyre, në kritere dhe elemente vlerësime të konsoliduar nga praktika Gjyqësore në zgjidhjen e geshtjeve analoge ose në përvojë përkatëse jashtë Gjyqësore, duke patur gjithnjë parasysh zhvillimin aktual ekonomik e social të vendit, përfshirë vlerën e parasë në ekonominë kombeëtare. Pala paditëse [redacted] është e ve referuar certifikatës së Vdekjes me Nr.Serie 012543345 datë 05.09.2017, vuan nga sëmundja me diagnozë "tik nervor", është e papunë (referuar Vërtetimit Nr.3755 Prot datë 06.03.2017 të Drejtorisë Rajonale Fier, Sherbimi Kombëtar i Punësimit), ka në përbërje familjare vajzën e saj [redacted] (referuar certifikatës Familjare me Nr.Serie 011476551 datë 01.12.2016) e cila është e papunë (referuar Vërtetimit Nr.845 Prot datë 25.09.2017 të Drejtorisë Rajonale Fier, Shërbimi Kombëtar i Punësimit). Në përfundim, Gjykata do të mbajë parasysh më së shumti ruajtjen e një raporti të drejtë midis proporcionalitetit të kënaqjes së interesave të dy palëve ndërgjyqëse, duke bërë të mundur që dëmshpërblimi të mos jetë simbolik dhe as mjet pasurimi i pajustificuar.

46. Pra, ashtu si konkludohet edhe në këtë vendim nisur nga natyra subjektive e këtij dëmi dhe veçanërisht nga karakteri, shfaqja e brendshme e tij, vërtetimi i cënimit të personalitetit të të dëmtuarit në turbullime, dhimbje e vuajtje shpirtërore, nuk mund të provohet në mënyrë tjetër përveçse duke i vlerësuar si të mbështetura ligjërisht dhe duke i çmuar si të provuara *ipso iure* me vërtetimin nga paditësit të vetë faktit të paligjshëm të të tretit dhe lidhjes së këtij fakti me cënimin moral të pësuar, sipas parimit të rregullshmerisë shkakësore. Pala e paditëse në gjykim arriti të provojë ekzistencën e faktit të kundërligjshëm dhe lidhjen shkakësore të tij me dëmin e shkaktuar, si në aspektin pasuror ashtu dhe moral. Për sa më sipër gjykata e vlerëson të provuar nga paditësja [redacted] ekzistencën e dëmit moral, shkaktuar nga fakti i kundërligjshëm, dëmtimit të paditëses si pasojë e diskriminimit
47. Edhe në lidhje me kërkimin për dëmin ekzistencial, Gjykata e Apelit e vlerëson të drejtë referimin që ka bërë gjykata e shkallës së parë në vendimin unifikues nr.12/2007, të Gjykatës së Lartë e cila është shprehur se: "Dëmi ekzistencial i shkaktuar nga fakti i paligjshëm i të tretit cenon të drejtat e personalitetit të njeriut duke dëmtuar thuhet në mënyrë të përhershme shprehjen dhe realizimin e të dëmtuarit si njeri, shfaqjen e personalitetit të tij në botën e jashtme, duke tronditur objektivisht jetën e përditshme dhe veprimtarinë e zakonshme të tij, duke i shkaktuar përkëqësime të cilësisë së jetës nga ndryshimi dhe prishja e ekuilibrit, sjelljes e zakoneve të jetës, të marrëdhënieve personale e familjare. Për shkak të një gjençajeje të tillë psiko-fizike, i dëmtuari nuk mund të kryejë më veprimtari të caktuara që karakterizojnë pozitivisht qënien e tij apo mund t'a karakterizojnë pozitivisht në të ardhmen, duke e detyruar të shtyhet drejt zgjidhjeve të ndryshme në jetë nga ato të dëshiruara e të pritshme apo në heqjen dorë nga këto të fundit për shkak të vërtetimit të faktit të paligjshëm. Dëmi ekzistencial, si shfaqje e jashtme e cënimit të interesave të ligjshme lidhur me cilësinë e jetës, ndryshe nga ai moral, është objektivisht i vërtetueshem dhe nuk mund të provohet vetëm me anë të prezumimeve të thjeshta."
48. Dëmi ekzistencial i shkaktuar nga fakti i paligjshëm i të tretit cenon të drejtat e

personalitetit të njeriut duke dëmtuar thuajse në mënyrë të perhershme shprehjen dhe realizimin e të dëmtuarit si njeri, shfaqjen e personalitetit të tij në botën e jashtme, duke tronditur objektivisht jetën e perditshme dhe veprimtaritë e zakonshme të tij, duke i shkaktuar përqendrim të cilësisë së jetës nga ndryshimi dhe prishja e ekuilibrit, sjelljes e zakoneve të jetës, të marrëdhënieve personale e familjare. Për shkak të një gjendjeje të tillë psiko-fizike, i dëmtuari nuk mund të kryejë me veprimtari të caktuara që karakterizojnë pozitivisht qenien e tij apo mund t'a karakterizojnë pozitivisht në të ardhmen, duke e detyruar të shtyhet drejt zgjidhjeve të ndryshme në jetë nga ato të dëshiruara e të pritshme apo në heqjen dorë nga këto të fundit për shkak të vërtetimit të faktit të paligjshëm. Dëmi ekzistencial, duke mos patur natyrë thjesht ndjesore e të brendshme, është objektivisht i vërtetueshem.

49. Për sa më sipër, në çështjen në shqyrtim, me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka konkluduar se është detyrim i paditëses [REDAKTUAR] të provojë në gjykim shkaktimin e dëmit ekzistencial shkaktuar nga fakti i kundërligjshëm. Për të provuar shkaktimin e dëmit ekzistencial, paditësja gjatë gjykimit kërkoi kryerjen e ekspertimit psikiatriko-ligjor. Në lidhje me detyrat e lëna nga gjykata në aktin e ekspertimit, eksperti psikolog ka arritur në përfundimin se: "...pala paditëse [REDAKTUAR] për shkak të shkarkimit nga puna prej të paditurit me bazë diskriminimin dhe pasojat konkretë të lidhura me këtë fakt, ka kaluar një situatë të ndryshme psikologjike e cila ka ndikuar në jetën e saj, në ndryshimin e funksioneve efektive, planet dhe objektivat duke cenuar ekuilibrin psikologjik, në formën e cënimit të personalitetit". Gjykata e Shkallës së Parë duke vlerësuar konkluzionet e ekspertit në aktin e ekspertimit në raport me karakteristikat e dëmit ekzistencial, me të drejtë ka konkluduar se paditësja [REDAKTUAR] i është shkaktuar dëm ekzistencial nga dëmtimi i shëndetit.
50. Referuar Aktit të Vlerësimit të dëmit të administruar në gjykimin në shkallë të parë rezulton se: "Dëmi jopasuror për palën paditëse [REDAKTUAR] është në vlerën totale prej 2.412.800 lekë". 32. Në përfundim, gjykata çmonn se kërkesë-padia duhet pranuar, pasi është e bazuar në ligj dhe në prova, dhe me konkretisht pala e paditur Shoqëria Albpetrol sh.a duhet të dëmshpërblejë palën paditëse Liljana Manaj për dëmin pasuror në masën 2.856.103 lekë dhe për dëmin jo pasuror (biologjik, moral, ekzistencial) në masën 2.412.800 lekë.
51. Së fundi, Gjykata e Apelit e gjen të pabazuar edhe pretendimin e ngritur në ankim nga pala e paditur lidhur me shpenzimet gjyqësore. Në rastin konkret pala e paditur është palë gjyqëmbësore, dhe shpenzimet gjyqësore në respektim të kërkesave të nenit 106 të K.Pr.Civile i ngarkohen asaj përpjestim me pjesën e pranuar të padisë.

**Si përfundim:** Kolegji Civil i Gjykatës së Apelit Vlorë, në kushtet kur rezulton se është zhvilluar një proces i rregullt ligjor përse i përket procedurës së gjykimit dhe kur çështja në themel, për ato shkaqe që është ankimuar rezulton se është zgjidhur drejt nga Gjykata, arrin në përfundimin se vendimi Nr.313, datë 08.03.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier duhet të lihet në fuqi si një vendim i drejtë i bazuar në prova dhe në ligj.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata e Apelit Vlorë, në mbështetje të nenit 466/a të K.Pr.Civile

**V E N D O S I**

Lënien në fuqi të vendimit Nr.313 (1235), datë 08.03.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Vlorë, më 18.10.2018

**A N Ë T A R**

**A N Ë T A R**

**K R Y E S U E S**

**NAZMI TROKA**

**KLODIANA GJYZARI**

**HYSEN SALIKO**

---